



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA O

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Odeljenje za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu

Department of Health and Social Welfare

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesje Sociale

Odeljenje za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu

Department of Health and Social Welfare

Nr. I prot

349

Më

02.02.23

Data/Datum/Date:	07.07.2023
Referenc-ë	
Për/Za/To:	Sekretarin e kuvendit komunal Rahovec
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	Znj.Saranda Sallteku, Drejtoreshë e DSHPS-së,Rahovec
Subjekti/Predmet/Subject:	Informat në Shëndetësi Janar- Qershor 2023

I nderuar,

Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale ka dy sektor:

1.sektori për shëndetësi

2.sektori për mirëqenie sociale

Aktivitetet e drejtorisë së DSHPS-së, gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2023 janë fokusuar kryesisht në ofrim të shërbimeve mjekësore për qytetarët e komunës së Rahovecit, për përmasimin e kushteve të punës punonjësve shëndetësorë.

Gjatë periudhe Janar – Qershor 2023 jane kryer gjithsej 55117 shërbime prej tyre

2160 raste Urgjente të trajtuara në sektorin e urgjencës

34061 terapi intramuskulare

2995 infuzione

2622 shërbime në laborator

1835 shërbime në Rtg

183 mamografi

1552 shërbime gjinekologjike

319 vizita shtëpiake

250 vizita shtëpiake për nena dhe fëmijë 0-3 vjeç

Në periudhën janar-qershor janë kryer 13 lindje në QKMF.

Për këto 6 muaj QKMF "Dr. Fahredin Hoti" ka kryer këto aktivitete:

Akreditohet programi i EVP për mjek dhe infermiere për vitin 2023.

Ne bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë kemi organizuar Karvanin e Vaksinimit aktivitet gjatë të cilit kemi vaksinuar persona me vaksina anticovid dhe kundër gripit sezonal.

Fale vizitave shtëpiake për nena dhe fëmijë kemi fituar grant nga UNICEF-i një veturë të re për nevojat e QKMF-se.

Ne këto periudha kemi funksionalizuar Sektorin e Urgjencës në QKMF me orar pune 24 ore 7 ditë të javës me 4 ekipe të përbërë nga 1 mjek dhe 2 infermiere. Ne të njëjtin muaj fillon edhe kursi i trajnimit për Urgjencë i infermiereve ku do të zgjasë 5 muaj gjatë të cilit do të trajnohen 50 infermiere.

Nga muaji maj kemi funksionalizuar sektorin e mjekësisë familjare edhe të dielave me orar 07:00-21:00 në këto periudha janë kryer vizitat sistematike të nxanësve në shkollat e komunës së Rahovecit, po ashtu kemi organizuar JAVEN E SHERBIMEVE SHENDETESORE FALAS NË KOMUNITETIN ku gjatë gjithë javës janë kryer shërbime mjekësore si matja e glikemisë, tensionit arterial dhe njehja e keshillave mjekësore etj.

Ne bashkëpunim me asociacionin e komunave të Maqedonisë Veriore kemi organizuar konferencën për menaxhim të pandemisë në kuadër të projektit të "SOLICO" projekt i bashkimit evropian për përvojat e menaxhimit të pandemisë në shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Është bërë përrurimi i renovimit të objektit të vjetër të QKMF-se, ku janë permisuar kushtet për ofrim sa më cilësor të shërbimeve mjekësore.

Është në përfundim e sipër ndërtimi i objektit të ri AMF-se, në lagjen e Epërme ku shumë shpejt do të përfundojë objekti, ku do të marrin shërbime pjesa dërmuese e qytetit.

Jane bler edhe dy autoambulanca të emergjencës për nevojat e QKMF-se.